

Hapet Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare



Tashmë të gjithë sipërmarrësit shqiptarë në Diasporë kanë një pikë takimi në Tiranë, Dhomen e Biznesit të Diasporës Shqiptare, një institucion i cili do të ofrojë informacion dhe mbështetjen për të gjithë sipërmarrësit shqiptarë në Diasporë të cilët dëshirojnë të investojnë në vendlindje. Dhoma Shqiptare e Biznesit nisi punën e saj në situatën e gjendjes së jashtëzakonshme që po kalon vendi ynë, me një nismë të veçantë, duke i bërë thirrje të gjithë sipërmarrësve shqiptarë për të kontribuar e për ti ardhur në ndihmë të gjitha familjeve shqiptare të prekura nga tërmeti i ditës së martë.

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Ministri i Shtetit për Diasporën fton të gjithë bashkëpunëtorët, shoqatat dhe bizneset të ofrojnë ndihmën e tyre në këtë moment solidariteti për familjet dhe qytetarët në nevojë të prekur nga tërmeti i ditës së martë, 26 nëntor. Kontributet vullnetare dhe ndihmat për këto familje, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania". <https://e-albania.al/dhuro/>

KKD/ Mark Gjonaj sjell në Shqipëri ekipin e eksperteve shqiptaro-amerikanë



Një grup ekspertësh shqiptaro-amerikanë nga Nju Jork-u i përbërë nga katër inxhinierë dhe dy arkitektë kanë arritur në Shqipëri për të dhënë kontributin e tyre në vlerësimin e shkollave, çerdheve e kopshte në zonat e problematike pas tërmetit. Ekspertët Ilir Dukaj, Malvin Ndoci Delin Bixha, Ediant Martinaj, Kreshnik Zalli dhe Sokol Huta të cilët janë të angazhuar në institucione të ndryshme amerikane, do të qëndrojnë rreth tetë ditë në Shqipëri. Ardhja dhe ekspertiza e tyre këtu u realizua me mbështetjen e Këshilltarit Bashkiak të Nju Jork-ut dhe anëtarin e KKD-së, Mark Gjonaj.

Nxënësit e "Petro Nini Luarasi" vizitë te Arbëreshët e Bullgarisë




Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ambasadën shqiptare në Sofje në kuadër të programit për eksplorimin e identitetit shqiptar, organizuan këtë fundjavë vizitën e nxënësve të gjimnazit "Petro Nini Luarasi" në dy qytete në Bullgari ku jetojnë komunitete shqiptare, Mandricë dhe Arbanas. Mandrica vazhdon të ruajë traditën e gjuhës së vjetër shqipe dhe këngëve të vjetra shqipe, ndërsa, Arbanasi ruan etimologjinë e Shqipërisë dhe rrënjëve shqiptare. Në Mandrica dhe Arbanasi, nxënësit eksplorojnë ruajtjen e traditave dhe identitetit kombëtar nga diaspora shqiptare në Bullgari. Nxënësi e gjimnazit "Petro Nini Luarasi" thajse një vit më parë ndërmoren nismën "Një Abetare në Diasporë", një nismë vullnetare për të dërguar tekste në gjuhën shqipe në shkollat e Diasporës.

Tërmeti / Ministri Majko dhe Mark Gjonaj në Durrës



Ministri i Shtetit për Diasporën dhe anëtar i Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut si dhe anëtar i KKD-së, Mark Gjonaj zhvilluan një vizitë në Bashkinë e Durrësit, një nga zonat e goditura nga tërmeti i ditës së martë. Së bashku me Gjonaj, ministri Majko vizitoi edhe familjen Lala për të shprehur ngushëllimet më të thella ndaj humbjes së tetë anëtarëve të kësaj familjeje, të cilëve u dha lamtumira e fundit.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Në Durrës ...



Në Thumanë...



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, Lazim Destani, Anila Hyka Smorgrav dhe Ardian Lekaj, në qendrën e koordinimit të urgjencës në Durrës dhe në Thumanë për të mbështetur banorët e prekur nga tërmeti.

Anëtar i KKD-së Lazim Destani ndihma për të prekurit nga tërmeti



Filantropi dhe Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Lazim Destani ishte ndër të parët shqiptarë të Diasporës i cili ofroi ndihmën e tij për të prekurit nga tërmeti i 26 Nëntorit. Ditën e mërkurë ai mbërriti në Shqipëri për të dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit kamionët me ndihma. Gjithashtu z. Destani vizitoi edhe disa nga zonat e prekura nga tërmeti.

Ansambli në SHBA, Koncerti i 28 Nëntorit për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti



Filloi me një minutë heshtje aktiviteti i Diasporës shqiptare në New York organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me artistët e Ansambli Kombëtar të Teatrit të Operas dhe Baletit për 28 Nëntorin. Ky koncert u shndërrua në një aktivitet për mbështetjen e familjeve të prekura nga tërmeti.